

Pasqyrat financiare dhe Raporti i Auditorit të Pavarur

OPERATOR TRANSMISIONI, SISTEMI DHE TREGU KOSTT SH.A.

31 dhjetor 2019

PËRMBAJTJA	FAQE
RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR	1
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	5
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE	6
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	7
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	8
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	9 - 36

Raporti i Auditorit të Pavarur

Grant Thornton LLC

Rr. Rexhep Mala 18
10 000 Prishtina
Republic of Kosovo
T +381 38 247 771
T +381 38 247 801
F +381 38 247 802
www.grantthornton-ks.com

Për Bordin Drejtues të KOSTT SH.A

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të KOSTT Sh.A. të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2019 dhe pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin e përfunduar, si dhe shënimet në pasqyrat financiare, duke përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë pozicionin financiar të Kompanisë më 31 dhjetor 2019 dhe performancën e saj financiare si dhe rrjedhën e parasë së saj për vitin e përfunduar në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen më tej në Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare në raportin tonë. Ne jemi të pavarur nga Kompania në përputhje me Bordin e Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kodin e Etikës së Kontabilistëve për Kontabilistët Profesionistë (Kodi BSNEK) së bashku me kërkesat etike që janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave financiare në Kosovë, dhe ne kemi përmbushur përgjegjësinë tonë etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se provat e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë.

Theksimi i Çështjes

Ne tërheqim vëmendjen si në vijim:

Gjatë gjithë vitit 2019 dhe më 31 dhjetor 2019, Kompania operon pa Bord të Drejtorëve të kompletuar. Si rezultat i kësaj, Kompania është e kufizuar në veprimtarinë e saj në disa fusha të tilla si procesi i aprovimit të buxhetit për vitin 2019, aprovimi i pasqyrave financiare dhe vendimmarrja e rëndësishme. Për më tepër, dhe për arsyen e mësipërme, Kompania operon pa Komitetin e Auditimit.

Efektet e mospërputhjeve të mësipërme me dispozitat rregullative nuk mund të vlerësohen me ndonjë siguri të arsyeshme në datën e raportimit.

Opinionin ynë nuk është modifikuar për shkak të çështjeve të mësipërme

Çështjet kryesore të Auditimit

Çështjet kryesore të auditimit janë ato çështje që, sipas gjykimit tonë profesional, kishin më shumë rëndësi në auditimin tonë të pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Këto çështje u trajtuan në kontekstin e auditimit tonë të pasqyrave financiare në tërësi, dhe në formimin e opinionit tonë mbi të, dhe ne nuk japim një opinion të veçantë për këto çështje.

Çështja kryesore e Auditimit

Rreziku i mashtrimit në njohjen e të hyrave

SNA supozon se ekziston rreziku i mashtrimit në njohjen e të hyrave në çdo angazhim të auditimit. Ne jemi përqendruar në njohjen e të hyrave sepse ekziston rreziku i mbivlerësimit të qëllimshëm të të hyrave nga menaxhmenti për të përmbushur objektivin e shitjeve dhe për të siguruar stimulimet nga performanca. Për më tepër, ekziston rreziku që Kompania mund të mos ketë regjistruar transaksione të të hyrave siç duhet në lidhje me kthimet dhe zbritjet e shitjeve në fund të vitit. Politikat e kontabilitetit, gjykimet dhe vlerësimet e lidhura janë shpalosur në Shënimin 3 në pasqyrat financiare shoqëruese.

Rreziku i tejkalimit të menaxhimit të kontrolleve të brendshme

Bazuar në SNA dhe metodologjinë tonë të auditimit, tejkalimi i menaxhimit të kontrolleve duhet të konsiderohet si një rrezik i rëndësishëm për çdo angazhim të auditimit. Menaxhmenti mund të manipulojë në mënyrë direkte ose indirekte të dhënat e kontabilitetit dhe të përgatisë pasqyra mashtruese financiare duke kontrolluar paragjykimet që përndryshe funksionojnë në mënyrë efektive.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të atyre të ngarkuar me Qeverisjen për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për kontrollin e brendshëm që përcaktohet nga menaxhmenti e që është i nevojshëm për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare që të jenë pa ndonjë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e hipotezës së vijimësisë së kompanisë, shpalosjet, qështjet e ndërlidhura me vijimësinë dhe përdorimin e bazës së vijimësisë në kontabilitet përpos nëse Menaxhmenti dëshiron të likuideojë kompaninë, ndërprejë operacionet ose nuk ka alternativë reale përpos ta bëjë këtë veprim.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku,

Si u trajtua çështja në auditimin tonë

Ne vlerësuam konsistencën e zbatimit të politikës së njohjes së të hyrave duke rishikuar politikën e kontabilitetit për burimet e ndryshme të të hyrave të Kompanisë. Ne testuam hartimin dhe efektivitetin e funksionimit të kontrolleve mbi sistemet e të hyrave për të përcaktuar shtrirjen e testeve thelbësore shtesë që kërkohet. Ne nuk kemi gjetur keqdeklarime materiale nga testimi ynë. Ne kontrolluam se të ardhurat ishin njohur në kohën e duhur duke testuar një mostër të transaksioneve dhe duke krahasuar datat e transportit, kundër të cilave të ardhurat ishin njohur. Asnjë përjashtim nuk u vërejt nga testimi ynë.

Ne testuam përshtatshmërinë e hyrjeve në ditar të regjistruara në librin kryesor duke u bërë pyetje individëve të përfshirë në procesin e raportimit financiar në lidhje me aktivitetin e papërshtatshëm dhe të pazakontë dhe hyrjet e testuara të ditarit. Ne kemi konsideruar nëse ka ndonjë dëshmi të gjyimit nga ana e Menaxhmentit në vlerësimet dhe gjykimet e rëndësishme të kontabilitetit të rëndësishme për pasqyrat financiare. Ne gjithashtu vlerësuam mjedisin e përgjithshëm të kontrollit të Kompanisë dhe intervistuam menaxhmentin e lartë.

pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të marra nga përdoruesit, bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedura auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si dhe marrim evidenca auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Risku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontrolleve të brendshme.
- Kuptojmë kontrollin e brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedura të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontrolleve të brendshme të kompanisë.
- Vlerësojmë konformitetin e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe informacioneve shpjeguese të bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim përfundime në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të menaxhmentit për parimin vazhdimësisë në kontabilitet bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, nëse ekziston një pasiguri materiale që lidhet me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e kompanisë për të përmbushur parimin e vijimësisë. Nëse nxjerrim përfundim se ekziston një pasiguri materiale, na kërkohet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit në shpalosjet përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse këto dhënie informacionesh shpjeguese janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona bazohen në provat e auditimit të fituara deri në datën e raportit tonë të auditimit. Sidoqoftë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të shkaktojnë që kompania të pushojë së funksionuari.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare përfaqësojnë transaksionet dhe ngjarjet në atë mënyrë që arrijnë paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brendshëm të cilat ne identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

Raport për kërkesat e tjera ligjore dhe rregullatore

1. Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen e Raportit të Menaxhmentit për operacionet e Kompanisë për vitin 2019 në përputhje me nenin 7 të Ligjit Nr.06-L-032 për kontabilitetin, raportimin financiar dhe auditimin. Përgjegjësia jonë, e thënë në nenin 10 të Ligjit, është të shprehim një opinion në lidhje me pajtueshmërinë me rregulloret dhe konsistencën e Raportit të Menaxhmentit me pasqyrat financiare të audituara të Kompanisë, për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2019.

Sipas opinionit tonë, Raporti i Menaxhmentit për operacionet e Kompanisë për vitin 2019:

- është në përputhje me pasqyrat financiare të audituara të Kompanisë për vitin që përfundoi më 31 Dhjetor 2019, dhe
- është përgatitur në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi (neni 7 i ligjit nr.06-L-032 për kontabilitetin, raportimin financiar dhe auditimin)

2. Për më tepër, ne deklarojmë se:

- ne nuk kemi ofruar shërbime të ndaluara jo-audituese të referuara në nenin 5 të UA nr.02/2019 dhe jemi të pavarur nga entiteti i audituar gjatë auditimit, dhe
- ne nuk kemi kryer ndonjë shërbim tjetër përveç auditimit ligjor mbi pasqyrat financiare të Kompanisë për vitin që përfundoi më 31 Dhjetor 2019

Grant Thornton LLC

Prishtinë,
31 mars 2019



Marijan Andonov
Auditor Ligjor

KOSTT SH.A.**Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2019***(Vlerat në "000" Euro)*

Shënime	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
PASURIA		
Pasuria afatgjatë		
Prona, impiantet dhe paisjet	4	174,037
Pasuritë e paprekëshme	5	557
	174,594	181,209
Pasuria afatshkurtër		
Stoqet	6	4,223
Llogaritë e arkëtueshme tregtare	7	6,586
Të arkëtueshmet tjera	8	4,811
Tatimi në fitim i arkëtueshëm		54
Investimet në CAO SEE	9	68
Paraja e gatshme dhe në bankë	10	27,657
Depozitat në banka	11	20,800
	64,199	40,445
GJITHSEJ PASURIA	238,793	221,654
DETYRIMET DHE KAPITALI		
Kapitali i aksionarëve		
Kapitali aksionar	12	25
Rezervat e transferit	13	53,367
Fitimi i mbajtur		58,790
	112,182	89,881
Detyrimet afatgjata		
Grantet e shtyera	14	63,278
Huazimet	15	44,902
	108,180	113,436
Detyrimet afatshurtra		
Maturimi aktual i huave afatgjata	15	5,738
Të pagueshme tregtare dhe të tjera	16	9,002
Tatimi në fitim i pagueshëm		442
Obligimet per tatimin e shtyre	25	3,249
	18,431	18,337
GJITHSEJ DETYRIMET	126,611	131,773
GJITHSEJ DETYRIMET DHE KAPITALI	238,793	221,654


Autorizuar për publikim nga Menaxhmenti i Kompanisë në 30 Mars 2020 dhe nënshkuara në emër të tyre nga:



Ilir Shala

Kryeshef Ekzekutiv

Nebih Haziri



Zyrtar Kryesor Financiar

Shënimet shoqëruese janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

KOSTT SH.A.**Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019***(Vlerat në "000" Euro)*

	Shënime	Viti i përfunduar më 31 dhjetor 2019	Viti i përfunduar më 31 dhjetor 2018
Të hyrat operative			
Të hyrat nga operator sistemi, transmissioni dhe tregu	17	37,366	14,450
Të hyrat tjera	18	29,759	24,163
		67,125	38,613
Shpenzimet operative			
Zhvlerësimi dhe amortizimi	4,5	(14,744)	(14,639)
Shpenzimet e personelit	19	(5,431)	(4,952)
Humbja në transmissiionin e energjisë	20	(4,564)	(5,983)
Riparimi dhe mirëmbajtja	21	(684)	(494)
Shpenzimet tjera operative	22	(17,367)	(12,551)
		(42,790)	(38,619)
(Humbja)/Fitimi operativ		24,335	(6)
(Humbja)/Fitimi para tatimit dhe interesit		24,335	(6)
Të hyrat financiare (shpenzimet)	24	(571)	(839)
(Humbja)/Fitimi para tatimit		23,764	(845)
Tatimi në fitim të korporatave	25	(1,463)	(476)
(Humbja)/Fitimi neto për vitin		22,301	(1,321)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Gjithsej të ardhura gjithëpërfshirëse		22,301	(1,321)

Shënimet shoqëruese janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

KOSTT SH.A.**Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019***(Vlerat në “000” Euro)*

	Kapitali aksionar	Rezervat e transferit	Fitimet e mbajtura	GJITHSEJ
Gjendja më 1 janar 2018	25	53,367	37,810	91,202
Transaksionet me pronarët	-	-	-	-
(Humbja) për vitin	-	-	(1,321)	(1,321)
Të hyrat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
Gjithsej të hyrat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	(1,321)	(1,321)
Gjendja më 31 dhjetor 2018	25	53,367	36,489	89,881
Gjendja më 1 janar 2019	25	53,367	36,489	89,881
Transaksionet me pronarët	-	-	-	-
Fitimi për vitin	-	-	22,301	22,301
Të hyrat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
Gjithsej të hyrat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	22,301	22,301
Gjendja më 31 dhjetor 2019	25	53,367	58,790	112,182

Shënimet shoqëruese janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

KOSTT SH.A.**Pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019***(Vlerat në "000" Euro)*

Shënime	Viti i përfunduar r më 31 dhjetor 2019	Viti i përfunduar më 31 dhjetor 2018
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative		
Humbja/Fitimi para tatimit	23,764	(845)
<i>Rregullimet për:</i>		
Zhvlerësimin dhe amortizimin	4,5	14,744
Të ardhurat nga interesi	24	(357)
Shpenzimet e interesit	24	928
Hedhja e pasurive fikse		10
Të ardhurat e shtyera nga grantet	14	(6,889)
Fitimi para ndryshimeve në asetet dhe kapitalin punues	32,200	7,754
Rritja në stoqe	(68)	20
Zvogëlimi / (rritja) në të arkëtueshmet tregtare	(2,747)	(1,762)
(Zvogëlimi) / rritja në të arkëtueshmet tjera	2,908	1,720
(Rritja) / zvogëlimi në të pagueshmet tregtare dhe të tjera	(1,141)	972
Tatimi mbi fitimin i paguar	(477)	(25)
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet Operative	30,675	8,679
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese		
Interesi i pranuar	357	243
Blerja e pronës, impianteve dhe paisjeve dhe pasuri te paprekshem	(8,284)	(14,086)
Investimi në depozita bankare	(12,000)	9,500
Paraja neto përdorur per aktivitetet investuese	(19,927)	(4,343)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese		
Interesi i paguar	(928)	(1,082)
Huatë e pranuar	5,786	8,662
Huatë e paguara	(5,738)	(5,531)
Të ardhurat neto nga grantet	1,794	96
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese	914	(2,145)
Rritja neto në para dhe ekuivalentët e saj		
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	10	15,995
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit	10	27,657

Shënimet shoqëruese janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

KOSTT SH.A.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019

(Vlerat në "000" Euro)

1. INFORMATA TË PËRGJITHSHME

Operatori i Transmisionit, Sistemit dhe Tregut (më tej "Kompania" ose "KOSTT SH.A."), ishte inkorporuar si një entitet i pavarur më 23 dhjetor 2005 nga transformimi i Korporatës Energjetike të Kosovës ("KEK") dhe ishte regjistruar si shoqëri aksionare sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/6 me datën 8 Shkurt 2001 në Organizatat Biznesore ("Rregullorja") me numër të regjistrimit të biznesit 70325350.

Kompania filloi të operojë në mënyrë të pavarur nga 1 Korrik 2006 sipas marrëveshjes në mes të KEK SH.A. dhe KOSTT SH.A. lidhur me marrëdhëniet tranzicionale, komerciale dhe operacionale në mes të KEK SH.A. dhe KOSTT SH.A. për transferimin e përgjegjësisë mbi operimet dhe mirëmbajtjen e rrjetit të Transmisionit të KOSTT SH.A.

Adresa e zyrës së Kompanisë është "Ndërtesa e Transmisionit", Isa Boletini Nr.39, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës.

Kosova ka shpallur pavarësinë e saj më 17 shkurt 2008. Në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-087 të datës 13 qershor 2008 në "Ligji mbi Ndërmarrjet në Pronësi Publike", Sistemi i Transmisionit dhe Operatori i Tregut SH.A është në pronësi të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Aktivitetet kryesore të kompanisë janë menaxhimi dhe operimi i sistemit të transmisionit të energjisë të Kosovës dhe është përgjegjëse për transmisionin e energjisë tek rrjetet elektrike me voltazhë të lartë. Si operator tregu Kompania është përgjegjëse për organizimin dhe administrimin e tregut të energjisë dhe gjithashtu menaxhon procesin e e barazimit perfundimtar

Këto pasqyra financiare janë të prezantuara në EURO, valutë të cilën e përdor Kompania për t'i kryer funksionet e saj.

Më 31 dhjetor 2019 kompania ka 347 punonjës (2018: 354).

2. ADOPTIMI I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR TË REJA DHE TË RISHIKUARA

2.1 Standardet e reja të miratuara më 1 janar 2017

SNRF 16 'Qiratë'

SNRF 16 "Qira" SNRF 16 'Qiraja' zëvendëson SNK 17 'Qira' së bashku me tre Interpretime (KIRFN 4 'Përcaktimi nëse një Marrëveshje përmban një Qira', SIC 15 'Qira-Nxitjet Operative' dhe SIC 27 'Vlerësimi i Substancës së Transaksioneve që përfshijnë Formën Ligjore të një Qiraje '). SNRF 16 kërkon që qiradhëniet të regjistrohen në pasqyrën e pozicionit financiar në formën e një pasuri me të drejtë përdorimi dhe një detyrim të qirasë. Ekzistojnë dy lehtësime të rëndësishme të parashikuara nga SNRF 16 për aktivet me vlerë të ulët dhe qiratë afatshkurtra më pak se 12 muaj.

Zbatimi i SNRF 16 nuk ka asnjë efekt në pozicionin financiar dhe performancën financiare të Kompanisë, si dhe për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2019 dhe 01 Janar 2019 gjithashtu, pasi që Kompania nuk ka kontratë qiraje në ato data dhe periudha të konsideruara.

2.2 Standardet dhe interpretimet e lëshuara që nuk janë ende efektive dhe ende nuk janë adoptuar nga kompania

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, IASB ka publikuar disa standarde të reja, por ende jo efektive, ndryshime të standardeve ekzistuese dhe interpretime si më poshtë:

- SNRF 17 Kontratat e sigurimeve;
- Përkufizimi i biznesit (Ndryshimet në SNRF 3);
- Përkufizimi i materialit (Ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8);
- Korniza Konceptuale për Raportimin Financiar

Asnjë nga këto Standarde ose ndryshime në Standardet ekzistuese nuk janë miratuar më herët nga Kompania. Menaxhmenti parashikon që të gjitha shpalljet përkatëse do të miratohen për periudhën e parë që fillon në ose pas datës efektive të shpalljes. Standardet, ndryshimet dhe interpretimet e reja që nuk janë miratuar në vitin aktual nuk janë shpalosur pasi ato nuk pritet të kenë një ndikim material në pasqyrat financiare të Kompanisë.

KOSTT SH.A.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019

(Vlerat në "000" Euro)

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL

Politikat kryesore kontabël të miratuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë paraqitur më poshtë. Këto politika janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha vitet e paraqitura, përveç nëse është shprehur ndryshe.

3.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare të bashkangjitura janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

3.2 Valuta funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare janë përgatitur si dhe për vitet që përfundojnë më 31 dhjetor 2017 dhe 2016. Të dhënat aktuale dhe krahasuese në këto pasqyra financiare janë paraqitur në Euro, e cila është gjithashtu valuta funksionale e Kompanisë.

3.3 Bazat e përgaditjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur nën koventën e kostos historike. Bazat e matjes janë përshkruar më detajisht në politikat e kontabilitetit më poshtë.

Përgatitja e këtyre pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon përdorimin e vlerësimeve të caktuara të kontabilitetit. Gjithashtu kërkon që menaxhmenti të ushtrojë gjykimin e tij në procesin e aplikimit të politikave të kontabilitetit të Kompanisë. Fushat që përfshijnë një shkallë më të lartë gjykimi ose kompleksiteti, ose fushat ku supozimet dhe vlerësimet janë të rëndësishme për pasqyrat financiare, shpalosen në Shënimin 3.24.

3.4 Transaksionet në valutë të huaj

Në fund të çdo periudhe të raportimit, zërat monetarë të mbajtur në valutë të huaj konvertohen në valutën funksionale me normat që mbizotërojnë në atë datë. Zëra jomonetarë të mbajtur me vlerë të drejtë që janë të shprehur në valutë të huaj konvertohen me normat mbizotëruese në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë. Zëra jo monetarë që janë matur në terma të kostos historike në valutë të huaj nuk rikonvertohen.

Diferencat e këmbimit për zërat monetarë njihen në fitim ose humbje në periudhën në të cilën ato ndodhin me përjashtim të:

- Diferencave të këmbimit nga huamarrjet në valutë të huaj që lidhen me pasuritë në ndërtim e sipër për përdorim produktiv në të ardhmen, të cilat janë të përfshira në koston e këtyre pasurive, kur ata konsiderohen si një rregullim i kostove të interesit për ato huamarrje në valutë të huaj.
- Diferencave të këmbimit për transaksionet e ndërmarra me qëllim të mbrojtjes nga rreziqet e ndryshme të valutave të huaja; dhe
- Diferencat e këmbimit për zërat monetarë të arkëtueshme nga ose të pagueshme ndaj një operacioni në valutë huaj për të cilin shlyerja nuk është planifikuar dhe as ka gjasa për të ndodhur (pra, duke formuar pjesë të investimit neto në operacionin në valutë të huaj), të cilat janë njohur fillimisht në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse dhe të riklasifikuara nga kapitali në fitim ose humbje në shlyerjen e detyrimit të zërave monetare.

KOSTT SH.A.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019

(Vlerat në "000" Euro)

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.5 Instrumentet financiare

Njohja dhe ç'regjistrimi

Pasuritë dhe detyrimet financiare njihen kur Kompania bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit financiar.

Pasuritë financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga pasuria financiare, ose kur transferohen pasuritë financiare dhe në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet. Një detyrim financiar çregjistrohet kur ajo shuhet, shkarkohet, anulohet ose skadon.

Klasifikimi dhe matja fillestare e pasurive financiare

Përveç atyre të arkëtueshme tregtare që nuk përmbajnë një material të konsiderueshëm financimi dhe maten me çmimin e transaksionit në përputhje me SNRF 15, të gjitha pasuritë financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë të rregulluar për shpenzimet e transaksionit (aty ku është e aplikueshme).

Aktivitetet financiare, të ndryshme nga ato të përcaktuara dhe efektive si instrumenta mbrojtëse, klasifikohen në kategoritë e mëposhtme:

- kostoja e amortizuar
- vlera e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDPPH)
- vlera e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDPATGJ).

Në periudhat e paraqitura Kompania nuk ka asnjë pasuri financiare të kategorizuar si VDPATGJ.

Klasifikimi përcaktohet nga dy:

- modelin e biznesit të njësisë ekonomike për menaxhimin e aktivitetit financiar
- karakteristikat e rrjedhës së pasurisë kontraktuale të aktivitetit financiar.

Të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me pasuritë financiare që njihen në fitim ose humbje janë paraqitur brenda kostove financiare, të ardhurave financiare ose zërave të tjera financiare, me përjashtim të depozitimit të tregtueshmërisë të arkëtueshme që paraqiten brenda shpenzimeve të tjera.

Matja e mëpasshme e pasurive financiare

Pasuritë financiare me koston e amortizuar

Pasuritë financiare maten me koston e amortizuar nëse pasuritë plotësojnë kushtet e mëposhtme (dhe nuk janë përcaktuar si VDPPH):

- ato mbahen brenda një modeli biznesi, qëllimi i të cilit është mbajtja e mjeteve financiare dhe mbledhja e flukseve monetare kontraktuale të saj
- kushtet kontraktuale të pasurive financiare krijojnë flukse të mjeteve monetare të cilat janë vetëm pagesa

principalit dhe interesit mbi shumën kryesore të papaguar

Pas njohjes fillestare, këto maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Zbritja është lënë jashtë ku efekti i zbritjes është jomaterial. Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj, tregtia dhe shumica e të arkëtueshmeve të tjera bien në këtë kategori të instrumenteve financiare

KOSTT SH.A.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019

(Vlerat në "000" Euro)

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.5 Instrumentet financiare(vazhdim)

Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes (VDPPH)

Pasuritë financiare që mbahen në një model biznesi të ndryshëm nga " të mbajtura për tu arkëtuar" ose "mbajtja për të grumbulluar dhe shitur" kategorizohen me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes. Më tej, pavarësisht nga asetet financiare të modelit të biznesit, flukset monetare kontraktuale të cilave nuk janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit, llogariten në VDPPH.

Pasuritë në këtë kategori maten me vlerën e drejtë me fitime ose humbje të njohura në fitim ose humbje. Vlera e drejtë e pasurive financiare në këtë kategori përcaktohet duke iu referuar transaksioneve aktive të tregut ose duke përdorur një teknikë vlerësimi ku nuk ekziston një treg aktiv.

Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera përmbledhëse (VDPATGJ)

Kompania llogarit pasuritë financiare në VDPATGJ nëse pasuritë plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- ato mbahen në një model biznesi, qëllimi i të cilit është "të mbajtura për tu arkëtuar" e parave të lidhura rrjedh dhe shesin dhe
- kushtet kontraktuale të aktiveve financiare krijojnë flukse të mjeteve monetare të cilat janë vetëm pagesa principalit dhe interesit mbi shumën kryesore të papaguar.

Çdo fitim ose humbje e njohur në të ardhura të tjera përmbledhëse (OCI) do të riciklohet pas mosnjohjes së aktivitetit.

3.6 Pronat, impiantet dhe paisjet

Pronat, impiantet dhe paisjet maten me kosto duke i zbritur zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga rënia në vlerë. Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejtë të ngarkueshme me blerjen e pasurisë. Kosto e pasurive të vetëndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës së drejtpërdrejtë (nëse është përfshirë), ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejtë me vënien e pasurisë në gjendjen funksionale për përdorimin e synuar. Kur pjesë të një elementi të pasurive afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të veçantë (përbërësit madhor) të pronës, impianteve dhe pajisjeve.

Fitimet dhe humbjet nga shitja e një zëri të pasurive afatgjata materiale përcaktohen duke krahasuar të ardhurat nga shitja me vlerën kontabël të pasurive afatgjata materiale dhe njihen neto brenda "të ardhura të tjera" në pasqyrën e të ardhurave.

Pronat në rrjedhën e ndërtimit për prodhim, ose për çështje administrative, ose për qëllime ende të papërcaktuara, barten në kosto, minus çdo humbje nga zhvlerësimi e njohur. Kosto përfshinë tarifatat profesionale dhe, për pasuritë e kualifikuara, koston e huamarrjes kapitalizohen në përputhje me politikat kontabël të kompanisë. Zhvlerësimi i këtyre pasurive, në të njëjtën bazë si aktivitetet e tjera të pronësisë, fillon kur pasuritë janë të gatshme për përdorimin e tyre të synuar.

Mobilet, orënditë, paisjet dhe automjetet paraqiten me koston e tyre pa zhvlerësim të akumuluar dhe pa humbjet e akumuluar nga dëmtimet.

KOSTT SH.A.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019

(Vlerat në "000" Euro)

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.6 Pronat, impiantet dhe paisjet (vazhdim)

Zhvlerësimi ngarkohet në atë mënyrë që të zvogëlojë koston ose vlerësimin e pasurive, përveç Tokës dhe pronave në ndërtim e sipër, gjatë jetës së tyre të vlerësuar të përdorimit, duke përdorur metodën lineare, si vijon:

Ndërtesat dhe rrjeti i transmisionit	2-50 vite
Impiantet dhe makineritë	7-15 vite
Mobilet, paisjet	2-16 vite
Vetura	5-10 vite

Në bazë të shtesave dhe hudhjeve gjatë vitit, zhvlerësimi ngarkohet prej muajit të blerjes deri te muaji përkatës i asgjësimit.

Jetët e vlerësuara të përdorimit, vlerat e mbetura dhe metodat e zhvlerësimit rishikohen në çdo fund vit, me efektin e ndonjë ndryshimi në vlerësimet kontabël në të ardhmen.

Fitmi ose humbja që vjen nga hudhja apo asgjësimi të ndonjë pjese të pronave, impianteve ose paisjeve përcaktohet si një diferencë në mes të të ardhurave nga shitja dhe vlerës kontabël të një aseti dhe është e njohur në pasqyren e të ardhurave dhe humbjeve dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse.

Kostot pasuese përfshihen në vlerën kontabël të pasurisë ose njihen si pasuri e ndarë, sipas rastit, sipas nevojës, vetëm atëherë kur është e mundshme që përfitimet ekonomike në të ardhmen të lidhura me atë artikull do të rrjedhin në kompani dhe kostoja e artikullit mund të matet në mënyrë të sigurt. Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtjet tjera paraqiten në pasqyren e ardhurave ose humbjeve dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse gjatë periudhës financiare në të cilën kanë ndodhur.

(Vlerat në "000" Euro)

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.7 Pasuritë e paprekshme

Njohja dhe matja

Pasuritë e paprekshme përbëhen nga licencat dhe programet kompjuterike. Këto pasuri të paprekshme janë paraqitur fillimisht me kosto dhe më pas me koston e tyre duke i zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë. Amortizimi është njohur në bazë lineare përgjatë jetës së pritshme të përdorimit. Jeta e dobishme dhe metoda e amortizimit rishikohen në fund të çdo periudhe raportuese, me efektin e ndonjë ndryshimi në vlerësim duke u llogaritur në baza të ardhme.

Shpenzimet pasuese

Shpenzimet pasuese janë kapitalizuar vetëm kur rriten përfitimet e ardhshme ekonomike të trupëzuara në pasurinë specifike për të cilën ato lidhen. Të gjitha shpenzimet tjera, përfshirë shpenzimet për emrin e mirë të krijuar brenda, njihet në fitim ose humbje në momentin kur ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi llogaritet mbi koston e pasurisë, duke i zbritur vlerën e saj të mbetur.

Amortizimi njihet në fitim ose humbje duke përdorur metodën lineare për softver me një normë vjetore prej 20%.

3.8 Stoqet

Stoqet maten me koston më të ulët dhe vlerën neto të realizueshme. Kostoja e stoqeve është e bazuar në parimin e "çmimit mesatar", dhe përfshin shpenzimet e shkaktuara me rastin e blerjes së inventarëve, kostot e prodhimit apo të konvertimit dhe shpenzimet e tjera të shkaktuara në sjelljen e tyre në vendin dhe gjendjen ekzistuese. Vlera neto e realizueshme është çmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhën normale të biznesit, minus kostot e vlerësuara të kompletimit dhe shpenzimet e shitjes.

Materialet dhe pjesët rezervë janë shpenzuar ose kapitalizuar, kur instalohen.

Një provizion për stoqe me qarkullim të ulët dhe inventarë të vjetëruar njihet në pasqyrën e të ardhurave, bazuar në vlerësimin më të mirë të menaxhimit.

3.9 Instrumentet financiare

Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e parasë përfshijnë bilancet e parave të gatshme, llogaritë bankare dhe depozitat me afat, me afat maturimi më pak se tre muaj.

Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera

Të arkëtueshmet tregtare regjistrohen fillimisht në shumën e arkëtueshme kundrejtë shitjes së produkteve. Në vazhdimësi, llogaritë e arkëtueshme paraqiten me koston e tyre nominale duke i zbritur provizionet për borxhet e dyshimta.

Lejimi për borxhet e dyshimta njihet kur ka dëshmi objektive që një arkëtueshmëri e caktuar është e dëmtuar.

Të pagueshmet tregtare dhe të tjera

Të pagueshmet tregtare dhe të tjera paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me koston e amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

KOSTT SH.A.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019

(Vlerat në "000" Euro)

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.9 Instrumentet financiare (vazhim)

Instrumentet tjera financiare

Instrumente të tjera jo-derivative janë matur me koston e amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv, minus ndonjë humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar i Kompanisë njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme janë të klasifikuara si kapital.

3.10 Zhvlerësimi i pasurive financiare

Kërkesat për zhvlerësim të SNRF 9 përdorin më shumë informacione të ardhshme për të njohur humbjet e pritshme të kreditit - 'modelin e humbjes së pritshme kreditore (ECL)'. Kjo zëvendëson SNK 39 'modelin e humbjeve të ndodhura'. Instrumentet në kuadër të fushëveprimit të kërkesave të reja përfshinin kreditë dhe pasuritë e tjera financiare të borxhit të matura me koston e amortizuar dhe VDPATGJ, llogaritë e arkëtueshme, pasuritë e kontratës të njohura dhe të matura sipas SNRF 15 dhe zotimet e huasë dhe disa kontrata të garancisë financiare (për emetuesin) nuk maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Njohja e humbjeve kreditore nuk është më e varur nga kompania që fillimisht identifikon një ngjarje të humbjes kreditore. Në vend të kësaj, kompania konsideron një gamë më të gjerë informacionesh gjatë vlerësimit të rrezikut të kredisë dhe matjes së humbjeve të pritshme kreditore, duke përfshirë ngjarjet e kaluara, kushtet aktuale, parashikimet e arsyeshme dhe të mbështetshme që ndikojnë në arkëtueshmërinë e pritshme të flukseve monetare të ardhshme të instrumentit.

Në zbatimin e kësaj qasjeje të ardhshme, bëhet një ndarje midis:

- instrumentet financiare që nuk janë përkeqësuar ndjeshëm në cilësinë e kredisë që nga fillimi njohjes ose që kanë rrezik të ulët kreditor ('Faza 1') dhe
- instrumentet financiare që janë përkeqësuar ndjeshëm në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare dhe rreziku i kreditorit të cilit nuk është i ulët ('Faza 2').

'Faza 3' do të mbulonte pasuritë financiare që kanë dëshmi objektive të zhvlerësimit në datën e raportimit.

'humbjet e pritshme kreditore në 12 muajtë 'njihen për kategorinë e parë, ndërsa' humbjet e pritshme kreditore të jetëgjatësisë 'njihen për kategorinë e dytë.

Matja e humbjeve të pritshme të kredisë përcaktohet nga një vlerësim i ponderuar me probabilitetin e humbjeve kreditore gjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar

3.11 Grantet qeveritare

Një grant qeveritar njihet vetëm atëherë kur ekziston një siguri e arsyeshme mbi kushtet prej të cilave përbëhet granti dhe që granti do të pranohet. Granti njihet si e ardhur gjatë periudhës që nevojitet të përputhet e ardhura me kostot e lidhura, për të cilat ata janë menduar të kompensohen, në bazë sistematike.

Nëse një grant bëhet i ripagueshëm, duhet të trajtohet si një ndryshim në vlerësimin. Kur granti është i lidhur me të ardhurat, shlyerja duhet të zbatohet fillimisht kundër ndonjë detyrimi të lidhur të paamortizuar të shtyrë, dhe çdo tejkalim duhet të trajtohet si shpenzime. Kur granti ndërlidhet me një pasuri, shlyerja duhet të trajtohet si rritje në vlerën kontabël të pasurisë ose zvogëlimin në bilancin e të ardhurave të shtyera. Amortizimi kumulativ që do të ishte ngarkuar nëse granti nuk do të ishte pranuar, duhet të ngarkohet si shpenzim.

KOSTT SH.A.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019

(Vlerat në "000" Euro)

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

Një grant i arkëtueshëm si kompensim për shpenzimet e bëra tashmë ose për mbështetje të menjëhershme financiare, pa shpenzimet e lidhura me të ardhmen, duhet të njihet si e ardhur në periudhën në të cilën ai është i arkëtueshëm. Përfitimi i një granti në një normë të ulët të interesit të tregut, trajtohet si një grant qeveritar, i matur nga diferenca midis të ardhurave të pranuar dhe vlerat e drejta të kredisë të bazuar në normat aktuale të interesit të tregut.

3.12 Detyrimet financiare

Duke qenë se kontabilizimi i detyrimeve financiare mbetet kryesisht i njëjtë sipas SNRF 9 krahasuar me SNK 39, detyrimet financiare të Kompanisë nuk janë ndikuar nga miratimi i SNRF 9. Megjithatë, për plotësi, politika kontabël është dhënë më poshtë.

Detyrimet financiare të Kompanisë përfshijnë huazimet, të pagueshmeve tregtare dhe të pagueshmeve tjera.

Detyrimet financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë dhe, kur është e aplikueshme, përshtaten për kostot e transaksionit, përveç nëse Kompania përcakton një detyrim financiar me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Më pas, detyrimet financiare maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, përveç derivativave dhe detyrimeve financiare të përcaktuara në VDPPH, të cilat mbahen më pas me vlerën e drejtë me fitime ose humbje të njohura në fitim ose humbje (përveç instrumenteve financiare derivative të cilat janë të përcaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtëse).

Të gjitha pagesat lidhur me interesin dhe, nëse është e zbatueshme, ndryshimet në vlerën e drejtë të një instrumenti që raportohen në fitim ose humbje përfshihen në kostot financiare ose të ardhurat financiare.

Metoda e interesit efektiv është një metodë e llogaritjes së koston së amortizuar të një detyrimi financiar dhe të alokimit të shpenzimeve të interesit gjatë periudhës përkatëse.

Norma e interesit efektiv është norma që zbrit pagesat e vlerësuara në kesh (duke përfshirë të gjitha tarifatat dhe pikat e paguara ose të pranuar që formojnë një pjesë integrale të normës efektive të interesit, kostove të transaksionit dhe primeve ose uljeve të tjera) gjatë jetës së pritshme të detyrimit financiar, ose (kur është e përshtatshme) një periudhë më të shkurtër, në vlerën kontabël neto në njohjen fillestare.

3.13 Njohja e të hyrave

Të hyrat maten me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose të arkëtueshme dhe përfaqëson shumën e arkëtueshme për mallrat dhe shërbimet e ofruara në rrjedhën normale të biznesit, duke zbritur zbritjet dhe taksat e lidhura me shitjet.

Për të përcaktuar nëse do të njohin të hyrat nga shërbimet, kompania ndjek një proces me 5 hapa:

- 1 Identifikimi i kontratës me një klient
- 2 Identifikimi i kushteve të performancës
- 3 Përcaktimi i çmimit të transaksionit
- 4 Alokimi i çmimit të transaksionit ndaj kushteve të performancës
- 5 Njohja e të hyrave kur / si kushtet e performancës janë të përmbushur

Të hyrat njihen ose në një moment ose në kohë, kur (ose) kompania përmbush kushtet e performancës duke transferuar mallrat ose shërbimet e premtuara për klientët e saj.

Kompania njih detyrimet e kontratës për shumën e marrë në lidhje me kushtet e performancës së pakënaqur dhe raporton këto shuma si detyrime të tjera në pasqyrën e pozicionit financiar. Në mënyrë të ngjashme, nëse Kompania përmbush një kusht të performancës para se të marrë shumën, kompania njih ose një pasuri të kontratës ose një të arkëtueshme në pasqyrën e saj të pozicionit financiar, në varësi të faktit nëse kërkohet diçka tjetër përveç kohës së kalimit para se të bëhet pagesa.

KOSTT SH.A.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019

(Vlerat në "000" Euro)

3.14 Përfitimet e punëtorëve

Kompania, në rrjedhën normale të biznesit, kryen pagesa në emër të vet dhe në emër të punonjësve të saj për të kontribuar për pensionin e detyrueshëm sipas legjislacionit lokal. Shpenzimet e bëra në emër të kompanisë janë ngarkuar në pasqyrën e të ardhurave në momentin kur ndodhin.

3.15 Provizionet

Provizionet njihen kur Kompania ka një detyrim aktual (ligjor ose konstruktiv) si rezultat i ngjarjeve të mëparshme, është e mundshme që Kompania do të kërkohet për të shlyer detyrimin, dhe një vlerësim i besueshëm mund t'i bëhet shumës së detyrimit.

Shuma e njohur si provizion është vlerësimi më i mirë i shumës që kërkohet për të shlyer detyrimin aktual në datën e bilancit, duke marrë parasysh rreziqet dhe pasiguritë që rrethojnë detyrimin. Kur një provizion matet duke përdorur rrjedhat e vlerësuar të flukseve monetare të nevojitura për të shlyer detyrimin aktual, vlera e tij kontabël është vlera aktuale e këtyre flukseve të mjeteve monetare (kur efekti i vlerës në kohë të parasë është material).

Kur disa ose të gjitha përfitimet ekonomike të kërkua për të shlyer një provizion pritet që të rikthehen nga një palë e tretë, një e arkëtueshme njihet si një pasuri nëse është pothuajse e sigurt që rimbursimi do të merret dhe shuma e arkëtueshme mund të matet në mënyrë të besueshme.

3.16 Kontratat me kushte të pavolitëshme

Detyrimet aktuale që lindin nën kontratat me kushte të pavolitëshme njihen dhe maten si provizione. Një kontratë me kushte të pavolitëshme është konsideruar të ekzistojë kur Kompania ka një kontratë në të cilën kostot e pashmangshme të përmbushjes së detyrimeve sipas kontratës tejkalojnë përfitimet ekonomike që priten të pranohen nga kontrata. Para se një provizion i veçantë për një kontratë me kushte të pavolitëshme është themeluar, një kompani njej çdo humbje nga zhvlerësimi që ka ndodhur mbi pasuritë dedikuar për këtë kontratë.

3.17 Të hyrat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të hyrat e interesit mbi llogaritë rrjedhëse. Të ardhurat nga interesi njihen kur ato ndodhin në pasqyrën e të ardhurave (fitim ose humbje), duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit mbi huazimet, dhe humbjet nga rënia në vlerë të njohura në pasuri financiare, (nëse ka).

3.18 Shpenzimet e huamarrjes

Kostot e huamarrjes drejtpërdrejt të atribueshme për blerjen, ndërtimin ose prodhimin e pasurive të ndërlidhura, të cilat janë pasuri që domosdoshmërisht marrin një kohë të gjatë për të qënë të gatshme për përdorimin e tyre të synuar ose të shitjes, janë shtuar në koston e këtyre pasurive, deri në kohën kur pasuritë janë të gatshme për përdorimin e tyre të synuar apo për shitje. Të gjitha shpenzimet e tjera të huamarrjes njihen në fitim ose humbje në periudhën në të cilën ato ndodhin.

3.19 Tatimi

Tatimi mbi fitimin paraqet shumën e tatimit aktualisht të pagueshëm dhe tatimin e shtyrë.

Shpenzimi mbi tatimin në fitim përfshin tatimin aktual dhe të shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në fitim ose humbje përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

Tatimi aktual është tatimi që pritet për t'u paguar ose arkëtuar mbi fitimin e tatuësishëm ose humbjen për vitin, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që konsiderohet në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme.

KOSTT SH.A.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019

(Vlerat në "000" Euro)

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.19 Tatimi (vazhdim)

Matja e tatimit të shtyrë reflekton pasojat tatimore që do të ndjekin mënyrën në të cilën kompania pret, në fund të periudhës raportuese, për të rimarrë ose shlyejë vlerën kontabël neto të pasurive dhe detyrimeve të saj. Tatimi i shtyrë është matur në norma të tatimit që pritet të aplikohen ndaj diferencave të përkohshme kur ato të ndryshojnë, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që konsiderohet si e miratuar në datën e raportimit.

Tatimi i shtyrë si pasuri njihet për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë në dispozicion kundër të cilit mund të përdoret ndryshimi i përkohshëm. Tatim i shtyrë si pasuri rishikohet në secilën datë të raportimit dhe reduktohet në masën që kjo nuk është e mundur që përfitimet nga tatimi do të realizohen.

Në përcaktimin e shumës së tatimit aktual dhe të shtyrë Kompania merr parasysh ndikimin e pozicioneve të pasigurta tatimore dhe nëse taksa dhe interesa të tjera mund të ngarkohen. Kompania beson se shumtë e njohura për detyrimet tatimore janë adekuate për të gjitha vitet tatimore të hapura bazuar në vlerësimin e shumë faktorëve, duke përfshirë interpretime të ligjit tatimor dhe përvojë paraprake. Ky vlerësim mbështetet në vlerësimet dhe supozimet dhe mund të përfshijë një seri të vendimeve rreth ngjarjeve të ardhshme. Informacion i ri mund të jetë në dispozicion që i shkakton Kompanisë për të ndryshuar vendimin e saj në lidhje me përshtatshmërinë e detyrimeve ekzistuese tatimore; ndryshime të tilla të detyrimeve tatimore do të ndikojnë në shpenzimin për tatimin në periudhën që një përcaktim i tillë është bërë.

3.20 Përcaktimi i vlerës së drejtë

Një numër i politikave dhe shpalosjet e kontabilitetit të kompanisë kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë, për të dyja, pasuritë dhe detyrimet financiare dhe jo financiare. Vlerat e drejta janë përcaktuar për qëllime të matjes dhe / ose shpalosjes duke u bazuar në metodat e mëposhtme. Kur është e aplikueshme, informacion i mëtejshëm mbi supozimet e bëra gjatë përcaktimit të vlerave reale është shpalosur në shënimet specifike të pasurisë ose detyrimit përkatës.

Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera

Vlera e drejtë e të arkëtueshmeve tregtare dhe të tjera, llogaritet si vlera aktuale e flukseve monetare të ardhshme, skontuar me normën e interesit të tregut për pasuri të ngjashme në datën e raportimit.

Detyrimet financiare jo-derivative

Vlera e drejtë, e cila është e përcaktuar për qëllime të shpalosjes, llogaritet në bazë të vlerës aktuale të rrjedhave monetare të principalit dhe interesit, të zbritur në normën e tregut të interesit në datën e raportimit.

3.21 Angazhimet dhe kontigjencat

Detyrimet kontingjente nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato shpalosen përveç nëse mundësia e një rrjedhje të burimeve që përfshinë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk njihet në pasqyrat financiare por zbulohet kur një fluks i përfitimeve ekonomike është i mundshëm. Shuma e një humbjeje të kushtëzuar njihet si provizion nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë se një detyrim i shkaktuar si në datën e pozicionit financiar dhe një vlerësim të arsyeshëm të shumës së humbjes që rezulton mund të bëhet.

3.22 Transaksionet me palët e ndërlidhura

Palët e ndërlidhura përcaktohen si ato palë që kanë kontroll mbi njëri-tjetrin ose kanë ndikim në vendimet financiare dhe operationale të njëri-tjetrit. Për qëllimet e shpalosjes së pasqyrave financiare, aksionerët e shoqërisë dhe subjektet e tyre përkatëse konsiderohen palë të lidhura.

KOSTT SH.A.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019

(Vlerat në "000" Euro)

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.23 Ngjarjet pas datës së raportimit

Ngjarjet pas vitit të fundit që ofrojnë informata shtesë për pozicionin e një kompanie në pasqyrën e pozicionit financiar (ngjarjet rregulluese) janë pasqyruar në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas fundvitit që nuk janë ngjarje të rregullimit shpalosen në shënimet kur janë materiale.

3.24 Vlerësimet kritike kontabël dhe burimet kryesore të pasigurisë në vlerësim

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë pritshmëritë e ngjarjeve të ardhshme të cilat besohet të jenë të arsyeshme në bazë të rrethanave. Kompania bën vlerësime dhe supozime në lidhje me të ardhmen. Përcaktohet që, vlerësimet e kontabilitetit shumë rrallë do të jenë të barabartë me rezultatet e ndërlidhura aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë një rrezik të rëndësishëm për të shkaktuar një rregullim material të shumat bartëse të aseteve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar janë adresuar më poshtë.

Jetët e dobishme e pronës, impianteve dhe pajisjeve

Siç përshkruhet në shënimin 3.6 më sipër, Kompania rishikon jetëgjatësinë e pronës, impianteve dhe pajisjeve në fund të çdo periudhe raportimi. Çdo ndryshim në përdorimin e vazhdueshëm të pronave apo faktor tjetër mund të ndikojë në jetët e dobishme të pasurive dhe në përputhje me rrethanat mund të ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme vlerën kontabël neto të këtyre pasurive.

Provizionet për rënien në vlerë të llogarive të arkëtueshme dhe të shlyerjes së inventarëve

Në rrjedhën normale të biznesit, Kompania e bën vlerësimin për rikthimin dhe realizimin e të arkëtueshmeve dhe inventarëve. Bazuar në këtë vlerësim, menaxhmenti njih një provizion të ërshatshëm për rënien në vlerë të llogarive të arkëtueshme dhe të inventarëve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga vlerësimi.

Tatimi

Ngarkesa e tatimit të Kompanisë në aktivitetet e zakonshme është shuma e totalit të ngarkesave tatimore aktuale dhe të shtyera. Llogaritja e pagesës totale tatimore të Kompanisë domosdoshmërisht përfshin një shkallë të vlerësimit dhe gjykimit në lidhje me zëra të caktuar, trajtimi tatimor i të cilëve nuk mund të përcaktohet përfundimisht deri sa është arritur një rezolutë me autoritetin tatimor përkatës ose, sipas rastit, nëpërmjet një procesi formal ligjor. Zgjidhja përfundimtare e disa prej këtyre zërave mund të kenë ndikim material në pasqyrën e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse dhe / ose variancave në rrjedhën e parasë.

KOSTT SH.A.**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019***(Vlerat në "000" Euro)***4. PRONA, IMPIANTET DHE PAISJET**

	Toka	Ndërtesa dhe Rrjeti i transmisionit	Impiantet dhe makineritë	Automjetet, mobiljet dhe paisjet tjera	Pasuritë në ndërtim e sipër	Gjithsej
Kosto						
Më 1 janar 2018	4,509	104,899	131,005	7,860	12,878	261,151
Shtesat	117	8	67	44	13,814	14,050
Transfer nga CIP		9	2,014	19	(2,042)	-
Hudhjet		-	(2)	-	-	(2)
Transfer në stoqe		-	-	-	(61)	(61)
Më 31 dhjetor 2018 / 1 janar 2019	4,626	104,916	133,084	7,923	24,589	275,138
Shtesat	329	1,417	510	140	5,614	8,010
Transfer nga CIP	-	6,799	19,725	110	(26,634)	-
Hudhjet	-	(2)	(8)	-	-	(10)
Transfer në stoqe	-	-	-	-	(145)	(145)
Më 31 dhjetor 2019	4,955	113,130	153,311	8,173	3,424	282,993
Zhvlerësimi i akumuluar						
Më 1 janar 2018	-	24,812	50,019	5,105	-	79,936
Zhvlerësimi për vitin	-	4,541	9,048	859	-	14,448
Më 31 dhjetor 2018 / 1 janar 2019	-	29,353	59,067	5,964	-	94,384
Zhvlerësimi për vitin	-	4,561	9,223	788	-	14,572
Më 31 dhjetor 2019	-	33,914	68,290	6,752	-	108,956
Vlera Neto						
Më 31 dhjetor 2018	4,626	75,563	74,017	1,959	24,589	180,754
Më 31 dhjetor 2019	4,955	79,216	85,021	1,421	3,424	174,037

Shtesat dhe grantet

Të përfshira në shumën totale të shtesave është shuma prej 1,794 mijë euro (2018: 97 mijë) që lidhen me zërat e impianteve dhe pajisjeve të marra përmes Grantit. Shuma e barabartë me normën e zhvlerësimit e cila i referohet këtyre asetëve prej 6,889 mijë euro (2018: 6,881 mijë euro) lirohet nga të ardhurat e shtyra dhe njihet si e ardhur nga granti në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse (shih Shënimin 14).

Për më tepër, shtesat në punën në progres përfshijnë kostot e huamarrjes të kapitalizuara në shumë prej 758 mijë (2018: 609 mijë euro). Norma mesatare e kapitalizimit për shpenzimet e interesit të përfshira në koston e pronave, pajisjeve dhe impianteve ishte 44.97 % (2018 : 36.01 %)

Shlyerjet

Më 31 dhjetor 2019, në bazë të numërimit vjetor të kryer në pasuritë afatgjata, kompania ka shlyer pasuritë jashtë përdorimit kundrejt fitimit dhe humbjes, në vlerë prej 10 mijë (2018: 2 mijë).

Pronat, impiantet dhe pajisjet të lëna peng

Më 31 dhjetor 2019 dhe 2018, nuk ka prona, impiantet apo pajisje të lëna peng. Të gjitha asetet janë përdorur për aktivitetet operative të Kompanisë

KOSTT SH.A.**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019***(Vlerat në "000" Euro)***5. PASURITË E PAPREKSHME**

	Softueri
Kosto	
Më 1 janar 2018	3,675
Blerja e softverit	36
Më 31 dhjetor 2018	3,711
Blerja e softverit	274
Më 31 dhjetor 2019	3,985
Amortizimi i akumuluar	
Më 1 janar 2018	3,065
Amortizimi për vitin	191
Më 1 dhjetor 2018	3,256
Amortizimi për vitin	172
Më 31 dhjetor 2019	3,428
Vlera neto në libra	
Më 31 dhjetor 2018	455
Më 31 dhjetor 2019	557

6. STOQET

	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
Pjesët reserve	3,686	3,576
Materialet dhe konsumimet	701	627
Të tjera	130	105
Karburantet dhe lubrifikantë	22	17
	<hr/>	<hr/>
Provizioni për inventar të vjetër	(316)	(316)
	<hr/>	<hr/>
Gjithsej	4,223	4,009

Më 31 dhjetor 2019, gjendja e stoqeve të Kompanisë duke përfshirë edhe inventarin e pranuar nga grantet është 21 mijë euro (31 dhjetor 2018: 32 mijë euro) (Shënimi 14).

7. LLOGARITË E ARKËTUESHME TREGTARE

	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
Të arkëtueshmet tregtare KEK J.S.C.	719	678
Të arkëtueshmet tregtare KESCO SH.A	5,570	3,051
Të arkëtueshmet tregtare IBER LEPENC	6	5
Të arkëtueshmet tregtare AIR ENERGY	78	54
Të arkëtueshmet tregtare EirGrid	102	-
Të arkëtueshmet tregtare tjera	111	51
	<hr/>	<hr/>
	6,586	3,839
Lejimet për të arkëtueshmet e dyshimta	-	-
Gjithsej	6,586	3,839

KOSTT SH.A.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019

(Vlerat në "000" Euro)

8. TË ARKËTUESHMET TJERA

	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
Avanset ndaj furnizuesve	248	688
TVSH e arkëtueshme	3,211	5,895
Të arkëtueshmet tjera	408	130
Paradhëniet për punëtor	247	259
Të arkëtueshmet nga jobalancat (Shënimi 16)	697	747
Gjithsej	4,811	7,719

Të arkëtueshmet nga jo balancat. Bazuar në Ligjin për Energjinë Elektrike, duke filluar nga viti 2017, kompania ka hyrë dhe është bërë përgjegjëse për balancimin e sistemit të ri të energjisë elektrike të Kosovës, në pajtim me Kodin e rrjetit të transmissioinit dhe rregullatorit të tregut. Si rezultat i kësaj, llogaritë e arkëtueshme dhe detyrimet përkatëse për jobalancat njihen në regjistrat kontabël të Kompanisë (shih gjithashtu Shënimin 16).

9. INVESTIMET NË CAO SEE

Më 31 dhjetor 2019 gjendja e investimeve në kompani të tjera ishte 68 mijë euro (31 dhjetor 2018: 68 mijë euro).

Më 4 korrik 2012, një kompani është themeluar dhe regjistruar si Kompani Projekt Ekipor me Përgjegjësi të Kufizuar e ngarkuar me krijimin e Zyrës për Kordinimin e Ankandëve të Evropës Juglindore, në Podgoricë (CAO SEE). Kjo kompani është e formuar nga TEL (Rumania), Eles (Sllovenia), HEP TSO (Croatia), BIH ISO (Bosnja dhe Hercegovina), MEPSO (Maqedonia), OST (Shqipëria), HTSO (Greqia), TEIAS (Turqia) dhe KOSTT (Kosova). Këto kompani kanë kontribuar me 30% të kapitalit aksionar në këtë entitet, përderisa me 70 % të kapitalit aksionar kanë kontribuar institucionet financiare ndërkombëtare (BERZH, KfW dhe USAID).

KOSTT ka investuar 28 mijë Euro në kapital aksionar të CAO SEE më 1 korrik 2012 kur ishte inkorporuar duke përfaqësuar 1% të aksioneve. Gjatë vitit 2014 kapitali aksionar i CAO SEE ishte rritur dyfish dhe KOSTT-i kishte rritur kapitalin aksionar të tij në 40 mijë Euro. Përqindja e aksioneve të KOSTT më 31 dhjetor 2018 ishte 1% (31 dhjetor 2017: 1%).

10. PARAJA NË DORË DHE NË BANKË

	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
Paraja në dorë	-	-
Paraja në bankë	27,657	15,995
Gjithsej	27,657	15,995

11. DEPOZITAT BANKARE

Më 31 dhjetor 2019 depozitat me afat përbëhen nga depozita afatshkurtra me bankat vendase në shumë prej 20.800 mijë euro (Me 31 Dhjetor 2018 8,800 mijë euro) me afat maturimi deri në dymbëdhjetë muaj me normë interesi që ndryshon nga 2.30 % në 2.45%.

KOSTT SH.A.**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019***(Vlerat në "000" Euro)***12. KAPITALI AKSIONAR**

	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
Kapitali aksionar i zakonshëm	25	25
Gjithsej	25	25

Pronari i KOSTT SH.A. është Republika e Kosovës duke mbajtur 100% të kapitalit aksionar të kompanisë më 31 dhjetor 2019 (31 dhjetor 2018: njëjtë).

13. REZERVAT E TRANSFERIT

	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
Prona, impiantet dhe paisjet	52,530	52,530
Stoqe	837	837
Gjithsej	53,367	53,367

14. GRANTET E SHTYERA

Grantet kanë të bëjnë me fondet ose pasuritë e fituara nga qeveria e Kosovës dhe / ose donatorët e tjerë me qëllim të veprimtarive operative të Kompanisë. Grantet e shtyra përbëhen nga parapagimet për projektet kapitale, të cilat janë në proces të ndërtimit dhe projekteve të ardhshme kapitale

Më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 balanca e granteve të shtyera është si në vijim:

	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
Grant në lidhje me prona, impiante dhe pajisje	61,230	66,304
Grant në lidhje me stoqet	2,048	2,069
Gjithsej	63,278	68,373

Lëvizjet gjatë vitit

Tabela më poshtë përmbledh lëvizjet e granteve të shtyera për periudhën prej 1 janar deri më 31 dhjetor:

	2019	2018
Më 1 janar	68,373	75,158
Shtesat (Shënimi 4)	1,794	96
Minus:		
Zvogëlimi i të ardhurave të shtyera (shiko tabelën poshtë)	(6,889)	(6,881)
Më 31 dhjetor	63,278	68,373

KOSTT SH.A.**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019***(Vlerat në "000" Euro)***14. GRANTET E SHTYERA (VAZHDIM)**

Në vazhdim është analiza e granteve të lëshuara, të regjistruara si e hyrë për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019:

	Viti i përfunduar më 31 dhjetor 2019	Viti i përfunduar më 31 dhjetor 2018
Zhvlerësimi i paisjeve (Shënimi 4)	6,868	6,849
Stoqet (Shënimi 6)	21	32
Gjithsej	6,889	6,881

15. HUAZIMET

	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
Huazime – afatgjata		
<i>Huazimet nga institucionet financiare</i>		
KfW		
Huazim KfW (shuma 17,000,000 euro, maturimi 2024)	9,000	11,000
Huazim KfW (shuma 23,500,000 euro, maturimi 2047)	17,742	19,366
EBRD		
Huazim EBRD (shuma 30,000,000 euro, maturimi 2029)	23,898	20,226
Gjithsej huazime afatgjata	50,640	50,592

Plani i ripagimit i huave afatgjata është si më poshtë:

	2019	2018
Deri në 12 muaj	6,014	5,529
1 deri 2 vite	6,014	5,529
2 deri 5 vite	19,856	19,856
Më shumë se 5 vite	18,756	19,677
	50,640	50,592

KOSTT SH.A.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019

(Vlerat në "000" Euro)

15. HUAZIMET (VAZHDIM)

Një kredi dhe marrëveshje e financimit e datës 28 dhjetor 2009 e nënshkruar në mes të KfW dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave të Republikës së Kosovës dhe Kompanisë. Projekti parashikon ndërtimin e të transmissioinit të linjës 400 kV Shqipëri-Kosovë (Tiranë-Prishtinë). Shuma totale e kredisë dhe marrëveshjes së financimit është 33.50 milion euro e përbërë nga 16.50 milionë euro kontribut financiar dhe kredi deri në 17.00 milionë euro. Kontributi financiar nuk do të rikthehet. Norma e interesit përcaktohet nga KfW, e llogaritur në bazë të kostove efektive të financimit të KfW-së plus një diferencë prej 150 pikë bazë. Kredia filloi të përdoret në vitin 2015.

Një marrëveshje huaje dhe financimi e datës 23 shtator 2013 ndërmjet KfW dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave të Republikës së Kosovës dhe Kompanisë. Projekti parashikon përmirësimin e rrjetit të transmissioinit - Faza IV dhe V. Shuma totale e marrëveshjes së huasë dhe financimit është 30.85 milionë euro, e përbërë nga 3 milion euro kontribut financiar, kredi deri në 20.5 milionë euro dhe 7.35 milion euro financuar nga fondet e Bashkimit Evropian. Kontributi financiar nuk do të rimburohet. Norma e interesit përcaktohet nga KfW. Kredia filloi të përdoret në vitin 2015.

Një marrëveshje kredie e datës 15 tetor 2014 u nënshkrua midis kompanisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). Ky projekt do të zbatohet brenda 4 viteve nga data e kontratës. Projekti parashikon përmirësimin e rrjetit ekzistues të transmissioinit të energjisë të kompanisë. Projekti është pjesë e planit katër vjeçar të investimeve kapitale të miratuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) dhe do të përfshijë ndërtimin, rehabilitimin dhe vënien në funksion të nënstacioneve, transformatorëve dhe linjave të transmetimit të energjisë elektrike. Kostoja totale e vlerësuar e projektit është rreth 36.50 milion euro. Burimet e parashikuara të financimit të projektit janë si më poshtë: 4.50 milion euro fondet e veta të kompanisë, 2.0 milion euro fonde të donatorëve, borxhi i lartë (BERZH) 30.0 milion euro. Norma e ofruar në vit për depozitat në monedhën e huasë është norma që shfaqet në normat e interesit të interesit ndërbankar të Eurozonës (Euribor).

16. LLOGARITË E PAGUESHME TREGTARE DHE TË TJERA

	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
Kreditorët – Të huaj	4,306	4,605
Kreditorët – Vendorë	3,532	4,332
Detyrimet për jobalancat (Shënimi 8)	697	747
Shpenzimet e përlllogaritura – Pagat	344	382
Tatimi në fitim dhe kontributet pensionale të pagueshme	33	20
Të tjera	90	56
Gjithsej	9,002	10,142

17. TRANSMISIONI I ENERGJISË

	Viti i përfunduar më 31 dhjetor 2019	Viti i përfunduar më 31 dhjetor 2018
Të ardhurat nga transmissioini i energjisë – KESCO	23,690	9,558
Të ardhurat nga operatori i sistemit	13,291	4,655
Të ardhurat nga operatori i tregut	385	237
Gjithsej	37,366	14,450

KOSTT SH.A.**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019***(Vlerat në "000" Euro)***18. TË ARDHURAT TJERA**

	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
Të ardhurat nga burimet e ripërtrishme të energjisë	18,289	10,115
Të e shtyra nga grantet	6,898	6,881
Të ardhurat nga jobalancat	2,775	709
Të ardhurat nga granti Qeveritar	-	1,000
Të ardhurat nga jobalancat-import	419	1,192
Të ardhurat nga lejimi financiar	132	2,672
Të ardhurat nga tranzitini energjise	1,000	1,007
Tjera	246	587
Gjithsej	29,759	24,163

Të hyrat nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë realizohen në bazë të Rregullës Nr. 10/2017 të Zyrës së Rregullatorit për Energji të Kosovës (ZRRE). Shpenzimet përkatëse nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë janë paraqitur në Shënimin 22.

Të hyrat nga jobalancat gjenerohen përmes balancimit të sistemit të ri të energjisë elektrike të Kosovës siç është shpallur me Ligjin për energji elektrike dhe Kodin e rrjetit të transmisionit dhe rregullatorit të tregut. Shpenzimet përkatëse për jobalancat janë paraqitur në Shënimin 22.

Të ardhurat nga Granti i Qeverisë. Gjatë vitit 2018, bazuar në një vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Kompania ka marrë një grant për mbulimin e shpenzimeve të furnizimit me energji elektrike të katër komunave veriore të Kosovës në vlerë prej 1,000,000 EUR.

19. KOSTOT E PERSONELIT

	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
Pagat e personelit	4,882	4,327
Kontributet pensionale	259	230
Pagat për punëtorët e kontraktuar	17	116
Kompenzim sipas performancave dhe të tjera	273	279
Gjithsej	5,431	4,952

20. HUMBJA NË TRANSMETIMIN E ENERGJISË

Gjatë vitit 2019 kompania ka njohur humbjet në transmetimin e energjisë në vlerë prej 4,564 mijë euro (2018:5,983 mijë euro). Humbjet e energjise elektrike ne rrjetin transmetues paraqiten si difference ne mes energjisë elektrike të matur në hyrje te rrjetit të transmisionit dhe energjise se matur ne dalje te rrjetit të transmisionit.

KOSTT SH.A.**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019***(Vlerat në "000" Euro)***21. RIPARIMET DHE MIRËMBAJTJET**

	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
Riparimet	532	360
Shpenzimet e mirëmbajtjes	152	134
Gjithsej	684	494

22. SHPENZIMET TJERA OPERATIVE

	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
Shpenzimet nga Burimet e Energjisë së ripërtitshme (Shënimi 18)	15,673	9,026
Shpenzimet e karburantit dhe lubrifikantëve	474	515
Shpenzimet për jobalancat import (Shënimi 18)	420	1,192
Shpenzimet për tranzitin e energjisë	134	372
Shpenzimet e rojave të sigurisë	133	166
Shpenzimet e udhëtimeve zyrtare	117	139
Shpenzimet e shërbimeve komunale	88	111
Shpenzimet e materialit për zyre dhe inventarit të imët	75	78
Shpenzimet për jobalancat (Shënimi 18)	69	511
Tatimi në prona dhe tatimet tjera	45	61
Shpenzimet e marketingut dhe përfaqësimit	39	42
Shpenzimet tjera-shp.doncion dhe e hyr-715-	37	236
Shpenzimet e trajnimeve	32	41
Shpenzimet e marketingut dhe sigurimit të automjeteve	18	40
Shpenzimet mjekësore	5	11
Tarifat bankare	8	10
Gjithsej	17,367	12,551

23. INSPEKTIMET TATIMORE

Gjatë vitit 2019, Kompania ka qenë nën kontrollin e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK). Fushëveprimi i ATK-së ishte të kontrollojë librat e Kompanisë lidhur me tatimin në fitim të korporatave për vitin 2018.

KOSTT SH.A.**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019***(Vlerat në "000" Euro)***24. TË HYRAT / SHPENZIMET FINANCIARE**

	Viti i përfunduar më 31 dhjetor 2019	Viti i përfunduar më 31 dhjetor 2018
Të hyrat nga interesi	357	243
Shpenzimet e interesit	(928)	(1,082)
Të hyrat/shpenzimet neto	(571)	(839)

25. TATIMI NË FITIM

Tatimi në fitim përbëhet si në vijim:

	Viti i përfunduar më 31 dhjetor 2019	Viti i përfunduar më 31 dhjetor 2018
Shpenzimi aktual i tatimit në fitim	880	-
Shpenzimi i tatimit të shtyrë	583	476
Gjithsej	1,463	476

Barazimi i tatimit aktual të fitimit me fitimin dhe humbjen për periudhat e konsideruara është si më poshtë:

	Viti i përfunduar më 31 dhjetor 2019	Viti i përfunduar më 31 dhjetor 2018
Fitimi/(humbja) para tatimit	23,764	(845)
Tatimi në fitim duke përdorur normën 10%	2,376	-
Efekti i tatimit për:		
Zhvlerësimi i lejuar sipas rregulloreve tatimore	(583)	(476)
Humbjet e bartura përpara	(953)	-
Shpenzimet e pazbritshme	40	19
Fitimi / (humbja) tatimore për vitin	880	-

Lëvizjet në tatimin në fitim të shtyrë janë si në vijim

	Viti i përfunduar më 31 dhjetor 2019	Viti i përfunduar më 31 dhjetor 2018
Gjendja hapëse e tatimit të shtyrë	2,666	2,190
Ndryshimet për vitin	583	476
Gjendja mbyllëse e tatimit të shtyrë më 31 Dhjetor	3,249	2,666

KOSTT SH.A.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019

(Vlerat në "000" Euro)

26. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR

Kompania është e ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- Rreziku i kapitalit
- Rreziku i tregut
- Rreziku i mallrave
- Rreziku i kredisë
- Rreziku i likuiditetit

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Kompanisë ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërme, objektivat, politikat e Kompanisë dhe proceset për matjen dhe administrimin e rrezikut, dhe menaxhimin e kapitalit të Kompanisë. Shënime të tjera sasiore janë përfshirë përgjatë këtyre pasqyrave financiare.

Menaxhmenti ka përgjegjësi të përgjithshme për vendosjen dhe mbikëqyrjen e strukturës së administrimit të rrezikut të Kompanisë.

Menaxhimi i riskut kryhet nga Bordi Drejtues i bazuar në disa të politika të para-aprovuara dhe të shkruara dhe procedurave që mbulojnë menaxhimin e përgjithshëm të riskut, si dhe fusha të veçanta, të tilla si rrezikun e normës së interesit, riskun e kredisë, përdorimin e letrave me vlerë të përshtatshme dhe investimin e tepërt të likuiditetit.

26.1 Rreziku i menaxhimit të kapitalit

Kompania menaxhon kapitalin e saj për të siguruar që do të jetë në gjendje për të vazhduar në vijimësi, duke maksimizuar kthimin e aksionarëve nëpërmjet optimizimit të bilancit të borxhit dhe të kapitalit.

Struktura e kapitalit të Kompanisë përbëhet nga borxhi neto (huazimet kompensuar nga bilancet e parave të gatshme dhe bankare) dhe kapitali i shoqërisë (i përbërë nga aksionet e emëtuara, rezervat dhe fitimet e mbajtura).

Menaxhmenti rishikon strukturën e kapitalit në baza të vazhdueshme. Si pjesë e këtij rishikimi, menaxhmenti konsideron koston e kapitalit dhe rrezikun e lidhur me secilën klasë të kapitalit.

Raporti i borxhit dhe kapitalit në fund të periudhës raportuese është si vijon:

	Viti i përfunduar më 31 dhjetor 2019	Viti i përfunduar më 31 dhjetor 2018
Borxhi (i)	50,640	50,592
Paraja e gatshme dhe paraja në bankë	(48,457)	(24,795)
Neto borxhi	2,183	25,797
Kapitali (ii)	112,182	89,881
Neto raporti borxh/kapital	1.95%	28.7%

(i) Borxhi është definuar si hua afatgjatë siç përshkruhet në shënimin 15.

(ii) Kapitali përfshinë të gjitha rezervat e kapitalit të Kompanisë që menaxhohen si kapital.

KOSTT SH.A.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019

(Vlerat në "000" Euro)

26. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

26.2 Rreziku tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimi në çmimet e tregut, si normat e interesit, kurset e këmbimit dhe çmimet e kapitalit do të ndikojnë në të hyrat e Kompanisë ose vlerën e instrumenteve të saj financiare. Objektivi i administrimit të rrezikut të tregut është të menaxhojë dhe kontrollojë ekspozimet ndaj rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, ndërsa duke optimizuar kthimin.

i) Rreziku i normës së interesit

Rreziku i normës së interesit është i përbërë nga rreziku që vlera e instrumentit financiar do të luhetet për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut dhe rrezikun që maturitetet e pasurive që mbartin interes ndryshojnë nga maturitetet e detyrimeve që mbartin interes të përdorura për të financuar këto pasuri (ri rreziku i çmimit). Gjatësia e kohës për të cilën norma e interesit është e fiksuar në një instrument financiar, pra tregon se në çfarë mase ajo është e ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit. Për vitet e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 kompania nuk është ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit.

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Pasuritë		
<i>Që nuk sjellin interes</i>		
Të arkëtueshmet tregtare, paradhëniet ndaj furnitorëve dhe të arkëtueshmeve të tjera	7,242	4,657
Paratë e gatshme	-	-
<i>Me normë fikse të interesit</i>		
Paratë në bankë dhe depozitat me afat	48,457	24,795
	55,699	29,452
Detyrimet		
<i>Që nuk sjellin interes</i>		
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera	7,886	8,993
<i>Me normë fikse të interesit</i>		
Huazimet	50,640	50,592
	58,526	59,585

(ii) Rreziku i valutës së huaj

Rreziku i tregut nuk është i përqendruar në rrezikun e monedhës së huaj, pasi shumica e transaksioneve të Kompanisë janë në monedhën vendase.

26.3 Rreziku i mallit

Rreziku i mallit i referohet paqartësive të vlerave të ardhshme të tregut dhe të madhësisë së të ardhurave në të ardhmen, të shkaktuar nga luhatjet në çmimet e mallrave. Kompania importon energjinë elektrike për të mbuluar deficitin në bilancin energjetik të Kosovës, duke e ekspozuar Kompaninë ndaj riskut të mallit.

KOSTT SH.A.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019

(Vlerat në "000" Euro)

26. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

26.4 Rreziku kreditor

Rreziku i kreditimit është rreziku i humbjes financiare të Kompanisë nëse konsumatori ose pala e kundërt ndaj një instrumenti financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet kontraktuale, dhe del kryesisht nga të arkëtueshmet e Kompanisë nga konsumatorët.

Ekspozimi ndaj rrezikut kreditor:

Vlera kontabël e pasurive financiare përfaqëson maksimumin e ekspozimit të kredisë. Ekspozimi maksimal i kredisë ndaj riskut të kredisë, për periudhën 12 mujore që përfundoi më 31 dhjetor 2019, paraqitet si më poshtë:

	Viti i përfunduar më 31 dhjetor 2018	Viti i përfunduar më 31 dhjetor 2017
Paraja në bankë	48,457	24,795
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera	7,242	4,657
Investimet në CAO SEE	68	68
Gjithsej	55,767	29,520

Në përcaktimin e rikuperueshmërisë së një llogarie të arkëtueshme, Kompania konsideron çdo ndryshim në cilësinë e kredisë së tregtimit të arkëtueshëm që nga data kur kredia fillimisht ishte dhënë deri në fund të periudhës raportuese.

Garancia e mbajtur si siguri

Kompania nuk mban asnjë kolateral ose zgjerime të tjera të kredisë për të mbuluar rreziqet e saj të kreditit që lidhen me aktivet e saj financiare.

26.5 Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Kompania do të has në vështirësi në përmbushjen e detyrimeve të lidhura me detyrimet financiare që do të përmbushen duke dhënë mjete monetare ose pasuri financiare tjetër.

Qasja e Kompanisë për menaxhimin e likuiditetit është të sigurojë, sa më shumë të jetë e mundur, se ajo vazhdimisht do të ketë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet kur ato duhet të paguen, ndër kushte normale dhe të vështirësuar, pa pësuar humbje të papranueshme apo duke rrezikuar dëmtimin e reputacionit të Kompanisë. Rreziku i likuiditetit lind në financimin e përgjithshëm të aktiviteteve të Kompanisë dhe në menaxhimin e pozicioneve. Ajo përfshin si rrezikun e të qenit në gjendje për të financuar pasuritë me maturime dhe norma të përshtatshme dhe rrezikun e të qenit të paaftë për të likuiduar një aktiv me një çmim të arsyeshëm dhe në një kornizë të përshtatshme kohore për të përmbushur detyrimet financiare.

Detyrimet financiare duke përfshirë edhe pagesat e interesit më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 2017, bazuar në maturimet e tyre kontraktuale janë të detajuara si më poshtë:

KOSTT SH.A.**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019***(Vlerat në "000" Euro)*

	Deri në 30 ditë	Nga 1 muaj deri 3 muaj	Nga 3 muaj deri 1 vit	Mbi 1 vit	Gjithsej
Pasuritë financiare					
Paraja në dorë dhe në bankë	27,657	-	20,800	-	48,457
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera	7,242	-	-	-	7,242
Gjithsej pasuritë financiare	34,899	-	20,800	0	55,699
Detyrimet financiare					
Të pagueshme tregtare dhe tjera	7,886	-	-	-	7,886
Huazimet	-	-	5,738	44,902	50,640
Gjithsej detyrimet	7,886	-	5,738	44,902	58,526
Hendeku i likuiditetit më 31 dhjetor 2019	27,013	-	15,062	(44,902)	(2,827)

	Deri në 30 ditë	Nga 1 muaj deri 3 muaj	Nga 3 muaj deri 1 vit	Mbi 1 vit	Gjithsej
Pasuritë financiare					
Paraja në dorë dhe në bankë	15,995	-	8,800	-	24,795
Të arkëtueshme tregtare dhe tjera	4,657	-	-	-	4,657
Gjithsej pasuritë financiare	20,625	-	8,800	-	29,425
Detyrimet financiare					
Të pagueshme tregtare dhe tjera	8,993	-	-	-	8,993
Huazimet	-	-	5,529	45,063	50,592
Gjithsej detyrimet	8,993	-	5,529	45,063	59,585
Hendeku i likuiditetit më 31 dhjetor 2018	11,632	-	3,271	(45,063)	(30,160)

26.6 Vlera e drejtë e instrumenteve financiare

Vlerat e drejtë e pasurive dhe detyrimeve afatshkurtra është e përafërt më vlerat e tyre kontabël për shkak të natyrës së tyre afatshkurtër. Vlera e drejtë e huave, gjithashtu përafëron vlerën e drejtë sepse edhe pse ato janë hua që mbartin norma fikse të interesit huadhënësi ka hequr dorë në kohë për të gjitha interesat nga kompania.

Vlera e drejtë e pasurive dhe detyrimeve financiare është e përfshirë në masën në të cilën instrumenti do të mund të shkëmbehet në një transaksion aktual midis palëve të vullnetëshme, përveç në një shitje të detyruar ose të likuidimit.

KOSTT SH.A.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019

(Vlerat në "000" Euro)

26. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

26.6 Instrumentet financiare të njohura me vlerën e drejtë (vazhdim)

Instrumentet financiare të njohura me vlerën e drejtë

Aktivitetet financiare të matura sipas vlerës së drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar në përputhje me hierarkinë e vlerës së drejtë janë paraqitur në tabelën e ardhshme. Kjo hierarki grupon aktivitetet dhe detyrimet financiare në tri nivele që bazohen në rëndësinë e të dhënave hyrëse të përdorura gjatë matjes së vlerës së drejtë të aktiveve financiare:

- **Niveli 1:** Çmimet e kuotuar (jo të rregulluara) në tregjet aktive për aktivitetet ose detyrimet identike;
- **Niveli 2:** të dhënat tjera hyrëse, përveç çmimeve të kuotuar, të përfshira në Nivelin 1 që janë në dispozicion për vrojtimin e aktivitetit ose të detyrimit, direkt (si psh. si çmime) ose indirekt (p.sh. përbërë nga çmimet) dhe
- **Niveli 3:** të dhënat hyrëse për aktivitetin ose pasivitetin që nuk janë të bazuara në të dhënat e disponueshme për vëzhgimin e tregut.

Kompania nuk ka asetet të klasifikuar në këto kategori në datën e pasqyrës së pozicionit financiar.

Instrumentet financiare që nuk janë prezentuar me vlerën e drejtë

Tabela në vijim përmbledh vlerat kontabël dhe vlerat e drejta për ato aktive dhe detyrime financiare që nuk janë paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar me vlerën e tyre të drejtë.

Më 31 dhjetor 2019	Vlera kontabël	Vlera e drejtë
Pasuritë financiare		
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera	7,242	7,242
Investimet në CAO SEE	68	68
Paraja në dorë dhe në bankë	48,457	48,457
Gjithsej	55,767	55,767
Detyrimet financiare		
Huazimet	50,640	50,640
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera	7,886	7,886
Gjithsej	58,526	58,526

Më 31 dhjetor 2018	Vlera kontabël	Vlera e drejtë
Pasuritë financiare		
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera	4,657	4,657
Pasuritë tjera	68	68
Paraja në dorë dhe në bankë	24,795	24,795
Gjithsej	29,520	29,520
Detyrimet financiare		
Huazimet	50,592	50,592
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera	8,993	8,993
Gjithsej	59,585	59,585

KOSTT SH.A.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019

(Vlerat në "000" Euro)

27. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA

Palët e lidhura përbëhen nga kompani, ndërmarrje të lidhura, kompanitë tjera të lidhura, drejtuesit e kompanisë dhe pjesëtarë të menaxhimentit kyç. Kompania në rrjedhën normale të biznesit kryen transaksione me palë të lidhura të ndryshme.

Të gjitha transaksionet me palët e lidhura janë kryer sipas termave dhe kushteve tregtare.

31 Dhjetor 2019	Grantet e shtyera	Të hyrat	Shpenzimet
Qeveria e Kosovës dhe Donatore tjere	63,278	6,889	-
Kompensim për menxhementin kyç	-	-	157
Anëtarët e Bordit	-	-	-
Gjithsej	63,278	6,889	157

31 Dhjetor 2018	Grantet e shtyera	Të hyrat	Shpenzimet
Qeveria e Kosovës- dhe Donatore tjere	68,373	6,881	-
Kompensim për menxhementin kyç	-	-	158
Anëtarët e Bordit	-	-	67
Gjithsej	68,373	6,881	225

28. ZOTIMET DHE KONTIGJENCAT

Kontestet

Më 31 dhjetor 2019 procedurat ligjore ngritur kundër kompanisë janë në gjithsej shumën prej 808 mijë EUR (31 dhjetor 201: 806 mijë euro). Asnjë provision nuk është njohur në datën e bilancit të gjendjes, pasi që këshillat profesionale tregojnë se nuk ka gjasa që ndonjë humbje e konsiderueshme do të lindë. Përveç kësaj, veprime të ndryshme ligjore dhe pretendime mund të pohohen në të ardhmen kundër Kompanisë nga konteste dhe kërkesave incident në rrjedhën e zakonshme të biznesit. Rreziqet e lidhura janë analizuar si në gjasat e shfaqjes. Edhe pse rezultati i këtyre çështjeve nuk mund gjithmonë të saktësohet, menaxhmenti i Kompanisë beson se nuk ka detyrime materiale që do të mund të ngjanin.

Detyrimet kontingjente më 31 dhjetor 2019 për punën e kontraktuar me kompani në shumën prej 2,038 mijë euro (31 dhjetor 2018: 15,280 mijë euro).

Borxhi afatgjatë

Një marrëveshje kredie e datës 15 tetor 2014 u nënshkrua midis kompanisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). Ky projekt do të zbatohet brenda 4 viteve nga data e kontratës. Projekti parashikon përmirësimin e rrjetit ekzistues të transmisionit të energjisë të kompanisë. Projekti është pjesë e planit katër vjeçar të investimeve kapitale të miratuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) dhe do të përfshijë ndërtimin, rehabilitimin dhe vënien në funksion të nënstacioneve, transformatorëve dhe linjave të transmetimit të energjisë elektrike. Kostoja totale e vlerësuar e projektit është rreth 36.50 milion euro. Burimet e parashikuara të financimit të projektit janë si më poshtë: 4.50 milion euro fondet e veta të kompanisë, 2.0 milion euro fonde të donatorëve, borxhi i lartë (BERZH) 30.0 milion euro. Norma e ofruar në vit për depozitat në monedhën e huasë është norma që shfaqet në normat e interesit të interesit ndërbankar të Eurozonës (Euribor).

KOSTT SH.A.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019

(Vlerat në "000" Euro)

28. ZOTIMET DHE KONTIGJENCAT (VAZHDIM)

Një kredi dhe marrëveshje e financimit e datës 28 dhjetor 2009 e nënshkruar në mes të KfW dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave të Republikës së Kosovës dhe kompanisë. Projekti parashikon ndërtimin e të transmisionit të linjës 400 kV Shqipëri-Kosovë (Tiranë-Prishtinë). Shuma totale e kredisë dhe marrëveshjes së financimit është 33.50 milion euro e përbërë nga 16.50 milionë euro kontribut financiar dhe kredi deri në 17.00 milionë euro. Kontributi financiar nuk do të rikthehet. Norma e interesit përcaktohet nga KfW, e llogaritur në bazë të kostove efektive të financimit të KfW-së plus një diferencë prej 150 pikë bazë.

Një marrëveshje huaje dhe financimi e datës 23 shtator 2013 ndërmjet KfW dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave të Republikës së Kosovës dhe kompanisë. Projekti parashikon përmirësimin e rrjetit të transmisionit - Faza IV dhe V. Shuma totale e marrëveshjes së huasë dhe financimit është 30.85 milionë euro, e përbërë nga 3 milion euro kontribut financiar, kredi deri në 20.5 milionë euro dhe 7.35 milion euro financuar nga fondet e Bashkimit Evropian. Kontributi financiar nuk do të rimbursohet. Norma e interesit përcaktohet nga KfW. Kredia filloi të përdoret në vitin 2015.

29. NGJARJET PAS DATËS SË RAPORTIMIT

Menaxhmenti i Kompanisë aktualisht po vlerëson ndikimin e mundshëm të situatës së koronavirusit mbi operacionet e tanishme të biznesit të Kompanisë. Menaxhmenti konsideron që kjo ngjarje është jo rregulluese në lidhje me pasqyrat financiare të Kompanisë, për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2019. Përveç kësaj, menaxhmenti konsideron që deri dhe nga data e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare, aktivitetet e kompanisë dhe pozicioni financiar mbeten materialisht të pa ndikuara nga kjo gjendje. Sidoqoftë, për shkak të pasigurisë së madhe të zhvillimit të ardhshëm të situatës së koronavirusit, brenda vendit dhe ndërkombëtarisht, nuk mund të bëhen vlerësime të sakta të ndikimit të mundshëm në të ardhmen mbi pozicionin financiar të Kompanisë dhe operacionet e biznesit. Menaxhimi i Kompanisë i konsideron me kujdes të gjitha masat e ardhshme aktuale dhe potenciale të Qeverisë dhe është e angazhuar të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të amortizuar krizën e ardhshme të shkaktuar nga pandemia e koronavirusit, në mënyrë që të sigurojë operacionet e vazhdueshme të biznesit duke planifikuar me kujdes likuiditetin e saj dhe duke i përshtatur situata e pësuar rishtazi në ekonominë lokale dhe globale.

Pas dates 31 dhjetor 2019 dhe deri në nxjerrjen e këtyre pasqyrave financiare, nuk ka ngjarje që do të ketë nevojë për shpalosje në pasqyrat financiare.